



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:010858
Datë: 18.10.2023
Numri i dokumentit: 04797963

C.nr.163/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm, sipas gjyqtarit: Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.Rr, K-Prizeren, të cilin e përfaqëson Av. B.Sh nga Peja, kundër të paditurit G.T nga Peja, me objekt kontesti Shpërblim Dëmi, vlera e kontestit 4.000 euro, jashtë seance me dt.18.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET poshtë padia e paditësit F.Rr, K-Prizeren, kundër të paditurit G.T nga Peja, me objekt kontesti Shpërblim i Dëmit, vlera e kontestit 4.000 euro.

A r s y e t i m

Paditësi me datë 21.01.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurit me objekt kontesti Shpërblim i Dëmit, vlera e kontestit 4.000 euro.

Gjykata me qëllim të krijimit të kushteve procedurale me aktvendimin C.nr.163/21, të datës 21.09.2023, e ka obliguar paditësin që brenda afatit prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, që në llogarinë bankare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, e përmes arkës së kësaj gjykatë, në emër të shpenzimeve të cilat do të krijohen rreth caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin G.T nga Peja, e tani me adresë të panjohur, të ia deponojë shumën prej 1.000 euro, si dhe gjykatës të ja prezantojë dëshminë për deponimin e bërë. Gjykata e ka njoftuar palën paditëse për pasojat procedurale se nëse brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, nuk e dorëzon dëshminë mbi deponimin e bërë të shumës së cekur gjykata do ta hedhë poshtë padinë.

I autorizuari i paditësit, aktvendimin C.nr.163/21, të dt.21.09.2023, e ka pranuar me dt.25.09.2023, dhe me parastresen e datës 26.09.23, ka njoftuar gjykatën se paditësi e ka të pamundur ta kryej deponimin e mjeteve financiare sepse është i pa punë, mirëpo pagesën do ta bëj pas çdo veprimi procedural. Mirëpo gjykata konstaton se pala paditëse nuk ka vepruar në kuptim të këtij aktvendimi, gjegjësisht gjykatës nuk i ka prezantuar dëshmi se ka deponuar shumën e parave në emër të shpenzimeve për përfaqësuesin e përkohshëm. Gjithashtu i njëjti nuk ka kërkuar as lirim me anë të parastresës së datës 26.09.2023, dhe i njëjti ka deklaruar se do të kryej pagesën pas çdo veprimi procedural. Mirëpo në bazë të Ligjit të Procedures Kontestimore nenin 81, par. 1 parashihet “ *Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga*

radha e avokatëve” si dhe në rastet nga paragrafi 2 i nenit 79 të këtij ligji i padituri ka për detyrë të deponojë shumën e të hollave për pagimin e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjtit neni shpenzimet i deponon paditësi.

Sipas dispozitës së nenit 391. 1, pika g), të LPK-së, shprehimisht parashihet se pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme po qe se konstaton se paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102, të LPK-së.

Prandaj, gjykata nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të nenit 79, 81, dhe 391. 1 pika g), të LPK-së, gjeti se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia e palës paditëse e ushtruar kundër palës së paditur duhet të hedhet poshtë si e palejuar, për çka gjykata edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:010858 - C.nr. 163/21, 18.10.2023**

**Gjyqtari
Besnik Shala**

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykatës